



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 40
Prishtinë, më 26 janar 2017, në orën 11:30
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-I-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Faton Topalli, Ali Sadriu, Hajdar Beqa, Abdyl Ymeri, Synavere Rysha, Naim Fetahu, Fikrim Damka, Enver Hoti dhe Bali Muharremaj.

Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Mentor Hyseni, GIZ.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Qendresa Mulaj, ZKA. Albert Krasniqi dhe Fjolla Uka, nga KDI, si dhe Dren Ajeti, GSJP.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 23.11.2016 dhe 08.12.2016;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së Komisionit për vitin 2016;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2017;
5. Inicimi i procedurave për Auditimin e Subjekteve Politike;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i amendamenteve për Projektligjin nr.05/L-122, për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;
7. Të Ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 23.11.2016 dhe 8.12.2016

Kryetari konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 23.11.2016 dhe 8.12.2016, u aprovuan pa ndryshime.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së Komisionit për vitin 2016

Kryetari, njoftoi deputetët se bazuar në Rregulloren e Punës së Komisionit si dhe në Rregulloren e Punës së Kuvendit, kërkohet aprovim i Raportit Vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2016, stafi i komisionit ka përgatitur raportin në fjalë. Pasi nuk pati të interesuar për të diskutuar në këtë pikë, e hodhi ne votim Raportin Vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2016.

Përfundim

KMFP, aprovoi Raportin Vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2016.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2017

Faton Topalli, kryetar, njoftoi deputetët se bazuar në Rregulloren e Punës së Komisionit si dhe në Rregulloren e Punës së Kuvendit, kërkohet aprovim i Planit Vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2017, së bashku me këtë edhe plani financiar. Stafi i komisionit ka përgatitur raportin në fjalë. Po ashtu, tha se është kërkesë e GIZ-it që në muajin maj apo prill të mbahet një takim me Komunitat për t'i shqyrtuar raportet e Auditimit të pranuar në komision nga viti paraprak. Me këtë hapi diskutimin.

Abdy Ymeri- Sipas planit të punës së Komisionit për vitin 2016, një numër të raporteve të analizuara nuk kemi mundur t'i shqyrtojmë në komision, a do të shqyrtohen të njëjtat për vitin 2017?

Naim Fetahu - Është mirë të dihet se çfarë shume e mjeteve është shpenzuar për vitin 2016 nga komisioni, prej shumës së ndarë prej 5 mijë eurove.

Fikrim Damka - Sa i përket shumës së mjeteve të ndara për komisione, vendos Kryesia e Kuvendit me vendim dhe kjo çështje nuk është në kompetenca të komisioneve.

Synavere Rysha, theksoi se pajtohet me shpërndarjen e shumës prej 5 mijë euro, të bërë nga stafi i komisionit, dhe se shpenzimet e bëra edhe për vitin 2016, kanë qenë të ulëta dhe shumë racionale.

Kryetari - Nëse do të ketë vonesa në ardhjen e raporteve të auditimit për vitin 2017, ne do të vazhdojmë me shqyrtimin e raporteve të pranuar gjatë vitit 2016. Po ashtu, gjatë vitit 2016, ne si Komision kemi shpenzuar 780 euro për një punëtorë dyditore, kjo me rastin e shqyrtimit të Projektligjit për ZKA-në.

Përfundim

KMFP-ja, aprovoi Planin e Punës së Komisionit bashkë me Planin e Buxhetit për vitin 2017, ashtu siç është përgatitur nga stafi mbështetës i Komisionit.

5. Inicimi i procedurave për Auditimin e Subjekteve Politike

Faton Topalli, kryetar, njoftoi deputetët dhe të pranishmit se në bazë të Ligjit Nr. 04/L-212, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174, për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-058, neni 11, Kuvendi i Republikës së Kosovës, përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, nëpërmjet një thirrjeje të hapur publike për aplikim, bënë përzgjedhjen e auditorëve, të cilët do të auditojnë Raportet Vjetore Financiare dhe Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës, të cilat dorëzohen nga subjektet politike në KQZ, në përputhje me standardet e kontabilitetit, të zbatueshme në Kosovë. Sipas kësaj baze ligjore ne si komision edhe viteve të kaluara kemi vepruar njësoj me dokumentacion, megjithatë puna në terren nuk është kryer, pra nuk ka pasur auditim të raporteve Financiare të Subjekteve Politike për shkak të mungesës së vullnetit politik. Me këtë hapi diskutimin.

Naim Fetahu - Nuk ka qenë e mundur të bëhet publikimi i raporteve financiare nga KQZ-ja dhe nga subjektet politike për shkak se këto raporte nuk janë audituar, prandaj si të tilla nuk kanë mundur edhe të publikohen.

Ali Sadriu - Aktivitetet që ka ndërmarrë KMFP-ja në kontest të adresimit të zgjidhjes së kësaj çështje, me kusht që raportet financiare të subjekteve politike të auditohen me kohë. Për këtë nuk ka qenë problem i vetëm mjetet financiare, problem në vete ka qenë mungesa e auditorëve ligjorë nga kompanitë audituese.

Abdyl Ymeri - Auditimi i raporteve financiare të subjekteve politike është i domosdoshëm, kjo për faktin se ka forma të shumta të financimit të subjekteve politike, duke filluar nga pagesat për anëtarësi, subvencionet e ndryshme, financimi nga donacionet e ndryshme. Ajo që duhet të dihet me këtë, është ligjshmëria e grumbullimit, shpërndarjes dhe raportimit për këto mjete. Deri tani ka mungesë të transparencës. Mungesa e zbatimit të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike si dhe moszbatimi i Rregullores 14/2015 për financimin e subjekteve politike dhe mbikëqyrjen e tyre. Partitë Politike duhet të auditohen nga ZKA-ja, sepse për momentin nuk kemi institucione mirë të specializuara në këtë fushë. Pa mbikëqyrje të mirëfilltë nuk do të kemi llogaridhënie. Po

ashtu dëshiroj të theksojë se subjektet politike nuk po i publikojnë raportet financiare në Ueb faqet e tyre.

Faton Topalli - Deri tani vetëm Lëvizja Vetëvendosje dhe AAK-ja i kanë bërë publike raportet e tyre financiare, ndërsa subjektet e tjera politike nuk i kanë bërë publike raportet e tyre financiare.

Naim Fetahu - Ne si KMFP, që të gjithë po pajtohemi që raportet financiare të subjekteve politike të auditohen, megjithatë së bashku me sekretarin e Kuvendit duhet të bëjmë zgjidhjen e kësaj problematike.

Enver Hoti- Nuk ka qenë vullneti politik të auditohen raportet financiare të subjekteve politike, për këtë nuk kanë qenë problem mjetet financiare. Baza ligjore për këtë ekziston, megjithatë mendoj se mungon vullneti politik.

Përfundim

KMFP-ja vendosi që t'i paraqesë kërkesë, Kryesisë së Kuvendit, që të autorizojë administratën e Kuvendit për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e auditorëve, të cilët do të auditojnë Raportet Vjetore Financiare dhe Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës, të cilat dorëzohen nga subjektet politike në KQZ, në përputhje me standardet e kontabilitetit të zbatueshme në Kosovë.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i amendamenteve për Projektligjin nr.05/L-122, për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike

Faton Topalli, kryetar, njoftoi të pranishmit dhe deputetët, lidhur me punën që është bërë në punëtorinë e mbajtur në Durrës më 19-22 janar 2017, me ç'rast janë përgatitur 19 amendamente. Në ndërkohë Ministria e Financave, ka dorëzuar disa vërejte të cilat i keni në tavolinë. Tani jemi në proces të dorëzimit të amendamenteve tona në komisionet e përhershme. Me këtë hapi diskutimin.

Hajdar Beqa - Është e panevojshme prapë t' i diskutojmë këto amendamente në Komision. Këto amendamente duhet të dorëzohen në komisionet e përhershme, ashtu siç jemi akorduar në punëtori.

Naim Fetahu - Nuk ka nevojë që sërish të diskutohen amendament tona në komision.

Përfundim

KMFP-ja, vendosi që amendamentet për Projektligjin nr.05/L-122, për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, të përgatitura nga stafi i KMFP-së në punëtorinë e mbajtur në Durrës më 19-22 Janar 2017, të adresohen për komisionet e përhershme.

7. Të Ndryshme

Faton Topalli, kryetar, njoftoi se më 3 shkurt 2017, për të diskutuar çështjen e Auditimit të Raporteve Financiare të Subjekteve Politike, është organizuar një takim. Në këtë takim janë ftuar deputetët nga Komisioni i Buxhetit si dhe nga Komisioni për Legjislacion.

Po ashtu, Topalli njoftoi se ZKA-ja e ka ftuar KMFP-në që me datën 2.2.2017, të vizitojë këtë institucion.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Faton Topalli